



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:102916

Datë: 12.10.2021

Numri i dokumentit: 02269421

P. nr.260/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. Z. nga Gjakova, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer tri vepra penale, vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore-Departamenti përgjithshëm në Gjakovë, me numër PP.nr.747/21, të datës 27.05.2021, me numër PP.nr.864/21, të datës 18.06.2021,dhe me numër PP.nr.1285/21, të datës 15.09.2021,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **30.09.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të akuzuarit, të mbrojtësit të tij.Blerina Kurtaj, avokate nga Gjakova, sipas autorizimit, të dëmtuarit F. G., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.12.10.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **SH. Z.**, data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim ne rr,“. . .” nr. . . , nga i ati N. dhe e ëma L. e vajzërisë M., i pamartuar, ka të kryer gjashtë klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, rom, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

I. Me datë 02.05.2021, rreth orës 01:00 në Gjakovë, rr. “. . .”, pikërisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit A. Z., me qëllim të përfitimi të kundërligjshëm pasuror për vete ia merr pasurinë e të dëmtuarit, në atë mënyrë që duke shfrytëzuar orët e vona të mbrëmjes, shkon në shtëpinë e kushëririt të tij, këtu të dëmtuarit A., hynë në shupën e shtëpisë dhe nga aty merr një thes me disa kablllo elektrike dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

II. Me dt.29.04.2021 rreth orës 03:00 në lagjen . . . , rr. “. . .”, në shtëpinë e të dëmtuarit F. G., i pandehuri Sh. Z. me dashje, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri shkon ne oborrin e shtëpisë hap derën pasi qe nuk ishte e mbyllur me çelës, futet brenda dhe nga aty merr dy thika kuzhine, një boks zërimi dhe disa gjera ushqimore dhe largohet nga aty duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm material në vlerë prej 115 euro.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale, vjedhje nga neni 313 parag.1 të KPRK-së

III. Me dt.10.06.2021, rreth orës 01:20 min, në lagjen . . . Komuna Gjakovë, saktësisht në hekurishten “. . .”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit L. P.nga fsh. J. K. Gjakovë, në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar orët e vona dhe mos prezencën e askujt shkon në hekurishten “. . .”, pronë e të dëmtuarit dhe nga aty merr 4(katër), bateri (akumulator), dy bateri të Kamionëve dhe dy të Veturave dhe largohet nga aty, pa u vërejtur nga askush, ku të njëjtat bateri i shet në hekurishten “. . .” në Gjakovë, në vlerë për 35.25 euro, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dëm material në vlerë rreth 100 euro.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4,17 par.1,38,39,40,42,43,69,70, 71,76, dhe nenit 313 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës,të akuzuarin:

G J Y K O N

1. Për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1, të përshkruar në dispozitivin e Aktakuzës me numër PP.nr.747/21, të datës 27.05.2021 .

DENIM ME GJOBË në shumë prej **100.-(njëqind)Euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

DËNIM ME BURGIM, ne kohëzgjatje prej **3(tre)muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

2.Për veprën penale, Vjedhje nga neni 313 par.1, të përshkruar në dispozitivin e Aktakuzës me numër PP.nr.864/21, të datës 18.06.2021

DENIM ME GJOBË në shumë prej **100.-(njëqind)Euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

DËNIM ME BURGIM, ne kohëzgjatje prej **3(tre)muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

3.Për veprën penale, Vjedhje nga neni 313 par.1, të përshkruar në dispozitivin e Aktakuzës me numër PP.nr.1285/21, të datës 15.09.2021

DENIM ME GJOBË në shumë prej **100.-(njëqind)Euro**, të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, si dhe

DËNIM ME BURGIM, ne kohëzgjatje prej **3(tre)muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

Për tri vepra penale, për të cilat është shpallur fajtor, në kuptim të nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPRK-ës,i shqipton **dënim unik**, dënim me burg në kohëzgjatje prej

7(shtatë)muajve, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **300.-(treqind)Euro**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Të dëmtuarit, A. A. Z. nga Gjakova rr". . ."pn.i dëmtuari, F. G. nga Gjakova, rr". . ." , I dëmtuari L. P. nga fsh. . . K. Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzat PP.nr.747/21, të datës 27.05.2021, me numër PP.nr.864/21, të datës 18.06.2021, dhe me numër PP.nr.1285/21, të datës 15.09.2021 kundër të akuzuarit Sh. Z. nga Gjakova, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepra penale, vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridiko penale ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.30.09.2021, mbrojtësja e të akuzuarit Sh. Z. Av. Blerina Kurtaj në F. të shqyrtimit fillestar, propozon gjykatës që të bëhet bashkimi i tri lëndëve penale P.nr.260/21, P.nr.311/21 dhe P.nr.453/21, në të cilat dyshohet se i ka kryer veprat penale të vjedhjes, nga neni 313 par.1 të KPRK-së, për shkak të ekonomizimit të procedurës dhe favoreve që do të krijohen për të mbrojturin tim.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj nuk e kundërshton propozimin e mbrojtësës së të akuzuarit Sh. Z. Av. Blerina Kurtaj, lidhur me bashkimin e tri lëndëve penale P.nr.260/21, P.nr.311/21 dhe P.nr.453/21, për hir të ekonomizimit në procedurë dhe favoreve që do të krijohen për të akuzuarin

Pasi Gjykata muarr mendimin e prokurorit të çështjes aprovoi propozimin e mbrojtësit së të akuzuarit Sh. Z., për bashkimin e tri lëndëve penale P.nr.260/21, P.nr.311/21 dhe P.nr.453/21, për shkak të veprave penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, për zhvillimin e një procedure të përbashkët penale në lëndët në numrat e lartë cekur, ashtu që do të zhvillohet procedura e përbashkët për 3 lëndët penale dhe do të identifikohen me numrin unik P.nr.260/2021.

I akuzuari Sh. Z., gjatë shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e pranoj fajësinë për veprat penale me të cilat akuzohem, ashtu siç janë përshkruar në dispozitivat e aktakuzës, për të cilat vepra jam penduar pa masë, tani jam në vuajtje të dënimit për një vepër të ngjashme penale, vuajtja e dënimit ka ndikuar në rehabilitimin tim, andaj vepra të tilla penale nuk do ti përsërisë, pas vuajtjes së dënimit do ti kthehem jetës normale, do të filloi të punoi dhe të kontribuo në familje, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Mbrojtësja e të akuzuarit Sh. Z. av. Blerina Kurtaj deklaron: të mbrojturit tim pasi që ia kam sqaruar në tërësi pasojat dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti e pranon fajësinë për

veprat penale me të cilën akuzohet, pa asnjë shtrëngim apo presion në bazë të nenit 248 të KPPK-së, dhe i propozoi gjykatës që këtë pranim ta aprovoi dhe në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, ndër rrethanat e tjera, siç është mosha e tij e re, pendimin i tij i sinqertë, gjendja e dobët ekonomike dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë vepër tjetër apo të ngjashme me këtë, dhe e lusim gjykatën që të shqiptoi një dënim sa më të butë, pasi që edhe me një dënim sa më të butë, do të mund të arrihet risocializimi i tij meqenëse i njëjti është veç në vuajtje të dënimi, po ashtu edhe preventiva gjeneralë dhe e posaçme.

I dëmtuari F. G. deklaroi, nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, unë si palë e dëmtuar i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe kërkoi kompensimin e dëmit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit Anton Hasanaj ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vullnet dhe vetëdije të plotë, pa presion, i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, po ashtu pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuzat.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari Sh. Z.; **I.** Me datë 02.05.2021, rreth orës 01:00 në Gjakovë, rr. “. . .”, pikërisht në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit A. Z., me qëllim të përfitimi të kundërligjshëm pasuror për vete ia merr pasurinë e të dëmtuarit, në atë mënyrë që duke shfrytëzuar orët e vona të mbrëmjes, shkon në shtëpinë e kushëririt të tij, këtu të dëmtuarit A., hynë në shupën e shtëpisë dhe nga aty merr një thes me disa kablllo elektrike dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

II. Me dt.29.04.2021 rreth orës 03:00 në lagjen . . ., rr. “. . .”, në shtëpinë e të dëmtuarit F. G., i pandehuri Sh. Z. me dashje, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë që natën kritike i pandehuri shkon në oborrin e shtëpisë hap derën pasi që nuk ishte e mbyllur me çelës, futet brenda dhe nga aty merr dy thika kuzhine, një boks zërimi dhe disa gjera ushqimore dhe largohet nga aty duke i shkaktuar të dëmtuarit dëm material në vlerë prej 115 euro.

III. Me dt.10.06.2021, rreth orës 01:20 min, në lagjen . . . Komuna Gjakovë, saktësisht në hekurishten “. . .”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit L. P. nga fsh. . . K. Gjakovë, në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar orët e vona dhe mos prezencën e askujt shkon në hekurishten “. . .”, pronë e të dëmtuarit dhe nga aty merr 4(katër), bateri (akumulator), dy bateri të Kamionëve dhe dy të Veturave dhe largohet nga aty, pa u vërejtur nga askush, ku të njëjtat bateri i shet në hekurishten “. . .” në Gjakovë, në vlerë për 35.25 euro, me ç' rast të dëmtuarit i shkaktonte dëm material në vlerë rreth 100 euro

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajit, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmbajnë aktakuzat, në materialet e prezantuara nga Prokurori

i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: mosha e tij e re në kohën e kryerjes së veprave penale, gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, kërkim falje publike të dëmtuarve, në bazë të këtyre gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, konform nenit 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së. Ndërsa si rrethana rënduese Gjykata morri parasysh, peshën e veprave të kryera, vendossh mërinë e tij për të kryer këto vepra penale, karakteristikat personale dhe sjelljet e mëparshme të akuzuarit, se edhe me pare kanë rënë ndesh me ligjin. Andaj duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të njëjtin e gjykoi me dënim të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do ti rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.260/2021 me datë 30.09.2021.

Sekretarja juridike
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Diana Sina

Numri i lëndës: 2021:102916
Datë: 12.10.2021
Numri i dokumentit: 02269421

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:102916
Datë: 12.10.2021
Numri i dokumentit: 02269421